

## Hapet thirrja për bursa për studentët në kuadër të Programit Erasmus + në Universitetin e Saarland-it, Gjermani

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Saarland-it në Gjermani për semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019.

### Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

### Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;
- Master;

### Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor (5 muaj);
- Master (5 muaj);

### Fushat e studimit:

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti Saarland, ku është e përcaktuar edhe gjuha e programit përkatës, klikoni në adresën:

<http://www.uni-saarland.de/campus/studium/vorlesungsverzeichnis.html>

### Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Bachelor**:

-CV (në gjuhën angleze);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studenti (të përkthyer në mënyrë zyrtare);

-Listë notash (të përkthyer në mënyrë zyrtare);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze;

-Certifikatë e gjuhës së huaj B1 (Anglisht/Gjermanisht në varësi të programit të studimit në Universitetin e Saarland-it);

-\*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Mobility Plan’’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Saarland lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti\* dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: [http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning\\_Agreement.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf)*

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Master**:

-CV (në gjuhën angleze);

-Kopje e Pasaportës;

- Vërtetim studentit (të përkthyer në mënyrë zyrtare);;
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash e nivelit Bachelor (të përkthyer në mënyrë zyrtare);
- Listë notash e nivelit Master (të përkthyer në mënyrë zyrtare);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze;
- Certifikatë e gjuhës së huaj B1 (Anglisht/Gjermanisht në varësi të programit të studimit në Universitetin e Saarland-it);
- \*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Saarland lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti\* dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: [http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning\\_Agreement.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf)*

**Afati për aplikim: 15 Maj 2018**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al) me subjekt: "Aplikim për bursë në Universitetin e Saarland, emrin dhe mbiemrin tuaj".

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!